



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.369/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e Isuf Osmani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Podujevës, nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/3093-2025 i datës 03.11.2025 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës për Kuvendet Komunale të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 05.11.2025, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHEN TË PABAZUARA ankesa ZL.Anr.369/2025, dhe ZL.Anr.370/2025, të datës 03.11.2025, parashtruar nga Isuf Osmani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Podujevës, nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/3093-2025 i datës 03.11.2025 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës për Kuvendet Komunale të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 03.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesat ZL.Anr.369/2025, dhe ZL.Anr.370/2025 nga Isuf Osmani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Podujevës, nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë

-Në ankesën ZL.Anr.369/2025, theksohet se nga diaspora i janë drejtuar së paku 70 vota në emrin e tij Isuf Osmani me nr. 10 kandidat për kuvend komunal të PDK-së në Podujevë, 49 vota janë vota familjar të vëllezërve në familje dhe djemt e xhaxhallarëve. Tutje thekson se mbi 30 vota i janë dërguar nga familja Azemi të fshatit Dumnicë të Podujevës që jetojnë në Gjermani me të cilët janë të afërt familjarisht për të cilat thekson se kanë edhe dëshmi, ndërsa në KQZ janë procesuar vetëm 25 vota ndërsa mungojnë një numër i madh i votave.

-Në ankesën ZL.Anr.370/2025 thekson se pas numërimit të votave ka pasur dy vëzhgues të cilët e kanë përcjellë procesin e numërimit të votave gjatë gjithë rrjedhës së numërimit në KQ dhe sipas raporteve të mbajtura çdo numërim të kutive të sjella me numër të vendvotimeve kanë vërejtur se ka parregullsi me të cilat mund të dëshmojnë, ku qendra e votimit në Llugë 1837-01 ka pasur numrin e tij me 4 vota, në vendvotimin 1837-02 ku 1 votë, kurse të raportuara nga KQZ është vetëm 1 votë dhe mungojnë 4 vota. I njëjti thekson se në vendvotimin 1802-01 i erdhen 9 vota, në vendvotimin 1802-02 i janë numëruar 7 vota, në vendvotimin 1802-03 i janë numëruar 3 vota, kurse tani në programin e KQZ figurojnë vetëm 10 vota, ku po nga ky vendvotim mungojnë 9 vota. Parashtruesi i ankesës thekson se këto 19 vota janë votat që është njoftuar nga dy vëzhguesit e tij. Parashtruesi i ankesës thekson se në vendvotimet 1812-01, 1812-02 dhe 1812-03 ka marrë 13 vota, kurse në programin e KQZ-se ka 4 vota, ndërsa për të njëjtat vota nga një zyrtar i qendrës së numërimit i ka thënë se ka 13 vota, ku thekson se mund të ofrojë dëshmi se në një vendvotim ishte vetëm 1 votë ndërsa në dy të tjerat ishin 12 vota. Parashtruesi i ankesës tutje thekson se sipas vëzhguesve të tij në vendvotimin 1837-01 në Llugë janë 4 vota, në vendvotimin 1837-02 në Llugë 1 votë, kurse kur janë precizuar votat në programin e KQZ-se figuron vetëm 1 votë, ndërsa vëzhguesi i tij i ka thënë se në shkolle ishin 5 vota në dy vendvotime.

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja thekson se sa i përket pretendimeve të palës ankuese, lidhur me ankesën A.nr.369, votat e familjarëve që kanë votuar përmes votimit me postë, ju njoftojmë se: Me datën 03.09.2025, KQZ ka miratuar Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime, Në faqen 14 të kësaj procedure shpjegohet mënyra e vlerësimit të pakove me fletëvotime, ndërsa pas përfundimit të procesit të verifikimit të zarfeve me fletëvotime, DSHV dorëzon në QNR listën e votuesve të cilët kanë votuar përmes postës dhe zarfet me fletëvotime të ndara në kuti sipas komunave të votuesve. Bazuar në nenin 17 të Rregullores Zgjedhore nr. 17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës parashihet numërimi i fletëvotimeve të dërguara me postë, sipas të cilës fletëvotimet që janë dërguar përmes postës dhe fletëvotimet që janë hedhur në kutitë e votimit nga procesi i votimit në përfaqësinë diplomatike, numërohen në QNR.

Ndërsa në nenin 20 të Rregullores Zgjedhore nr. 14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, parashihet procedura e numërimit të fletëvotimeve në QNR, përkatësisht, në paragrafin 9 të nenit 20 parashihet se: Zarfet e votimit me postë hapen dhe numërohen pas përfundimit të krahasimit të listave votuese të përcaktuara në nenin 18 të kësaj rregullore si dhe pas përfundimit të numërimit të votave në përfaqësi diplomatike.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese, lidhur me ankesën A.nr.370, ju njoftojmë se: Bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr. 16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave të cilit do W, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV. KQZ, gjithashtu njofton se, procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren

Zgjedhore Nr. 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar. Pala ankuese, ndër të tjera, ka pretenduar se disa nga familjarët kanë votuar për të mirëpo, sipas tij mungojnë votat e tyre. Ky pretendim nuk mund të vërtetohet, pasi që vota është e fshehtë dhe, në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës, dhe po ashtu në fletëvotim nuk mund të identifikohet emri i votuesit. Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese i cili mbështetet në pritshmërinë dhe deklaratimet e personave, dhe familjareve të tij, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit. Pala gjithashtu pretendon se, sipas njoftimeve të marra nga disa vëzhgues të tij, një pjesë e votave që i atribuohen atij pretendon se, mungojnë dhe nuk janë përfshirë në sistemin e KQZ-së. Megjithatë, këto pretendime mbështeten në të dhëna jozyrtare dhe të pa verifikuara, andaj nuk mund të merren si prova të vlefshme apo të besueshme. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, po ashtu nuk ka bashkëngjitur prova relevante, që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendim et tij. KQZ njofton se i gjithë materiali zgjedhor, (duke përfshirë kamerat e sigurisë, Librat e Votimit dhe Formularët) gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendorsjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr..05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZL.A.nr.369/2025 dhe ZL.A.nr.370/2025 të datës 03.11.2025, të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët ZL.A.nr.369/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesave dhe shkresave të lëndës konstaton se:

Ankesat janë të pabazuara

Paneli, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore lidhur me ankesën ZL Anr 369/2025 dhe përgjigjes në ankesë të KQZ-së, vlerësoj se pretendimet në ankesën e parashtruar nga Isuf Osmani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Podujevës, nga radhët e Subjektit Politik PDK, me pretendimet se i mungojnë votat familjarëve të tij që jetojnë në diasporë, për Panelin këto pretendime janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga pretendimet e theksuara në ankesë se ka mungesë të votave të publikuara me numrin real të votave të konfirmuara nga familjarët e tij dhe nga disa persona tjerë, paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e tij, kjo pasi që paraqitësi i ankesës nuk i ka bashkëngjitur ankesës asnjë provë dhe nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e tij se i mungojnë votat, ndërsa pretendime e theksuara në ankesë tani për tani mbeten në nivel të supozimit nga se nuk janë argumentuar me fakte dhe me prova konkrete.

Ndërsa pretendimet e theksuara ne ankesën ZL. Anr. 370/2025 se ka mospërputhje të rezultateve të numrit të votave të publikuara dhe se ka mungesa të votave të cilat i janë numëruar ne vendvotime dhe nga dëshmitarët në teren, paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e tij. Kjo pasi që ankuesi nuk i ka bashkangjitur ankesës prova bindëse që mbështesin pretendimet e tij, ndërsa me provat që janë në shkresat e lëndës dhe atë nga dëshmitë postare të cilat parashtuesi i ankesës i ka paraqitur si provë dëshmojnë se është bërë votimi nga diasporabota e jashtme, por nuk mund të vërtetohet se është votuar pikërisht për parashtuesin e ankesës përkatësisht është e pa mundur që të vërtetohet një fakt i tillë, ndërsa pretendimi i tij në ankesë se në emrin e tij Isuf Osmani me nr. 10 kandidat për kuvend komunal të PDK-së në Podujevë, 49 vota janë vota familjar të vëllezërve në familje dhe djemt e xhaxhallarëve, tutje ka pretenduar se mbi 30 vota i janë dërguar nga familja Azemi të fshatit Dumnice të Podujevës që jetojnë në Gjermani me të cilët janë të afërt familjarisht, këto pretendime nuk kanë mundur të provohen ndërsa prova tjera nuk ka parashtuar, prandaj në këto rrethana nuk është arritur të argumentohen pretendimet e tij se i mungojnë votat. Kështu që pretendimet e theksuara në ankesë tani për tani mbeten vetëm në suaza të dyshimit nga se nuk janë provuar me fakte dhe në prova relevante apo konkrete. Po ashtu Paneli vlerësoi se deklaratat e votuesve apo mënyrat tjera të përdorura me të cilat pretendohet se kanë votuar një kandidat të caktuar nuk mund të merren si prova të besueshme dhe të bazuara për faktin se nuk mund të vërtetohet në asnjë formë se votuesit përkatës të kenë votuar për subjektin e caktuar dhe kandidatin e caktuar për shkak se asnjë fletëvotim nuk mund të identifikohet me emrin e votuesit”.

Me nenin 101 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcaktohet se *“votat për kandidatët e subjekteve politike numërohen në qendrat komunale të numërimit të fletëvotimeve për kandidatë”*, ndërsa paragrafi 13 i këtij neni përcakton se: *“të dhënat dhe rezultatet për çdo vendvotim dërgohen për tabulim në QNR menjëherë pas përfundimit të punës së çdo ndërrimi. Kopjet e formularëve të rezultateve skanohen, publikohen dhe vendosen në vende të qasshme për vëzhguesit, si dhe ju ofrohen subjekteve politike dhe kandidateve, sipas kërkesës”*.

Rregulla Zgjedhore e KQZ-së Nr. 16/2024 Qendrat Komunale të Numërimit neni 18 paragrafi 1 përcakton se *“pas mbylljes së kutisë së votimit, rezultatet dhe formularët skanohen dhe publikohen në web faqen e KQZ-se, vendosen të qasshme në QKN për vëzhguesit dhe ju ofrohen subjekteve politike dhe kandidateve sipas kërkesës”*.

Bazuar në dispozitën e sipërcituara paneli ka gjetur se kandidati në fjalë përkundër që ka pasur mundësi të informohet përmes QKN-së në Podujevë si dhe përmes web faqes së KQZ-së, për votat të cilat i ka të fituara zyrtarisht të publikuara nga vet KQZ-ja, i njëjti në ankesën e tij nuk ka sqaruar se sa vota i ka në dispozicion gjegjësisht se sa vota i ka fituar në bazë të njoftimeve të publikuara nga vet KQZ-ja dhe sa vota pretendon se i mungojnë, gjegjësisht cila është mos përputhshmëria ne mes të votave të publikuara nga KQZ-ja në fazat paraprake në krahasim me rezultatin përfundimtar të KQZ-së, andaj pretendimet e tij ishin të përgjithësuara, të papërcaktuara, e që në fakt pretendimet e palës ankuese më shumë paraqiteshin si pritshmëri të saja për një numër më të madhe të votave.

Paneli vlerëson se pretendimet e tilla janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë, parashtuesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj me prova konkrete, të ligjshme se ka pasur mungesë të votave, por se pretendimet e ankuesit janë më shumë pritshmëri e tij për më shumë vota, e jo që në realitet ka pasur mungesë të votave.

Paneli, vlerësoi se ankesa është e pabazuar dhe e pa argumentuar, pasi që parashtuesi i ankesës nuk ka bashkangjitur prova bindëse, apo ndonjë dëshmi, formularët e rezultateve të subjekteve politike dhe të kandidatëve, librin e votimit, deklaratat e KVV apo dokumente të tjera, me të cilën do të vërtetoheshin këto pretendime, andaj nuk mund të vërtetohet se ka shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së. Andaj neni 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcakton se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtuesja e ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.369/2025 më datën 05.11.2025

Kryesues i Panelit
Skender Çoçaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.